

VENDIM
Nr.636, datë 14.5.2008

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË ADMINISTRATËS SË AKADEMISË SË
SHKENCAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strukturës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, gjithsej, 31 veta, sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA E ADMINISTRATËS SË AKADEMISË SË SHKENCAVE

1. KRYESIA	3
- Kryetar	1
- Zëvendëskryetar	1
- Sekretar shkencor	1
2. DEGA E PERSONELIT DHE SEKRETARIA E KRYESISË	1
- Kryetar dege, sekretar	1
3. SEKSIONET SHKENCORE	7
- Seksioni i shkencave natyrore e teknike	4
- Kryetar i seksionit (Akademik)	1
- Sekretar shkencor i seksionit (Profesor)	1
- Punonjës shkencor për projektet (Profesor)	1
- Asistent i seksionit (Arsim i lartë)	1
- Seksioni i shkencave shoqërore albanologjike	3
- Kryetar i seksionit (Akademik)	1
- Sekretar shkencor i seksionit (Profesor)	1
- Asistent i seksionit (Arsim i lartë)	1
5. DEGA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE ME PUBLIKUN	1
- Kryetar dege	1
6. DEGA E BOTIMEVE SHKENCORE	6
- Botime periodike shkencore në gjuhë të huaj Studia Albanica (Revistë); Albania Journal Natyral and Technical Sciences (Revistë);	2
- redaktor shkencor	2
- botime të veprave të rëndësishme shkencore (monografi, traktate, studime)	3
- redaktor	1
- specialist-editor	1
- ICT-administrator	1
- Specialist, marketing libri	1

7. DEGA E FINANCËS DHE ADMINISTRATËS		9
- Kryetar i degës		1
- Financiere buxheti		1
- Protokoll-arkivist		1
- Magazinier-mirëmbajtje		1
- Kaldaist-portier		1
- Shoferë		3
- Pastruese		1
8. BIBLIOTEKA SHKENCORE		4
- Përgjegjës (me gradë shkencore)	1	
- Bibliografe		1
- Bibliotekare	1	
- Pastruese		1
GJITHSEJ NUMRI I PUNONJËSVE		31